

## ***KONTRATË dhe STATUT***

### ***Për krijimin e shoqërisë "Ivi & Helios Trade Investment" Shpk***

Zt. Ivi Guri i biri i Aristotelit i dt. 25.01.1990 lindur dhe në Tiranë, Rr. Q. Stafa, P. 161, shk. 3 ap.11, me ID nr. J00125074L

*dhe*

Zt. Helios Lamaj i biri i Agronit dt. 13.02.2005 lindur dhe banues në Tiranë Rr. R. Collaku, P. Aurora ap. 22 me ID nr. K50213029L

*është quajtur më poshtë Ortakë*

Vendosin sot më dt. 10.02.2023 të krijojnë shoqërinë Ivi & Helios Trade Investment shpk (shkurt I&H TI shpk) me qëndër në Tiranë/Shqipëri, me Kontratën dhe Statutin e mëposhtëm:

#### ***§ 1. Firma dhe Selia***

- (1) Firma e shoqërisë do të quhet "Ivi & Helios Trade Investment shpk" shpk (shkurt I & H T&I).
- (2) Ortak të shoqërisë "Ivi & Helios Trade Investment shpk" janë Zt. Ivi Guri dhe Helios Lamaj.
- (3) Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë Rr. Q. Stafa, P. 161, shk. 3 ap.11.
- (4) Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### ***§ 2. Objekti i ndërmarrjes.***

Objekt i ndërmarrjes është aktiviteti i prodhimit si edhe i tregtisë. Për më tej paraqitja për përfitim të koncesioneve në fushën e prodhimit, porositja, importimi, montimi, ndërtimi dhe vënia në punë e linjave të ndryshme prodhuese, aktiviteti i import eksportit për produkte të ndryshme të produhuara nga vetë Firma ose edhe nga të tretët, pjesëmarja në projekte të ndryshme në fushën e fshatrave turistikë ose edhe në fusha të tjera të prodhimit dhe shërbimit. Po ashtu me qëllim të ushtrimit të aktivitetit të mësipërm edhe zbatimi i kontratave Fason (porosisë) me të tretë si për interesat e tregut vendas ashtu edhe të huaj. Së fundi dhe çdo objekt tjetër, që shërben për kryerjen e investimeve ose veprimitarisë së eksport importit. Ajo ka të drejtë të marrë pjesë edhe në shoqëri të tjera

#### ***§ 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë***

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

#### **§ 4. Kapitali Shoqërisë**

- (1) Kapitali i shoqërisë është në shumën 100 000 Lek, i përbërë nga dy kuota me vlerë nominale nga 50 000 Lek, që zotërohet 50 % nga ortaku Ivi Guri dhe 50% nga ortaku Helios Lamaj.
- (2) Shoqëria „Ivi & Helios Trade Investment shpk” nuk mund të ofrojë kapitalin si mjete investimi për publikun e gjerë.
- (2) Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (3) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

#### **§ 5. Drejtimi i shoqërisë dhe përfaqësimi**

##### **5.1. Administratori**

- (1). Shoqëria ka një ose disa administratorë. Nëse shoqëria ka emëruar vetëm një administrator, ky është përfaqësuesi i vetëm i shoqërisë. Administrator i shoqerisë për një periudhë prej tre vjetësh është Z. Ivi Guri.
- (3) Administratori i nënshtrohet detyrimit të besnikërisë, heshtjes, informimit dhe bindjes. Gjatë ushtrimit të detyrave ai duhet të marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakut.
- (4) Administratori, Kohëzgjatja dhe Kompetencat e përfaqësimit caktohen me vendim të Asambleja Përgjithshmetë shoqërisë.
- (5) Me vendim të Asambleja Përgjithshme të shoqërisë administrimi mundet ti caktohet nëpërmjet një kontrate administrimi edhe një Avokati ose një subjekti të përshtatshëm. Ky vepron si administrator i shoqërisë.
- (6) Ortakët e shoqërisë dhe Administratori nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë.

##### **5.2. Asambleja Përgjithshme**

- (1) Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit dhe kompetencat e tij;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimit për administratorin dhe personat e përmendur në shkronjat "ç" të kësaj pike;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- gj)riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

(2) Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme për shoqërinë „Ivi & Helios Trade Investment shpk“ ushtronë nga ortakët e shoqërisë.

#### *§ 6. Prishja e shoqërisë*

Shoqëria Ivi & Helios Trade Investment shpk prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) për arsyet e tjera, të parashikuara në ligj.

Ortakët e shoqërisë Ivi & Helios Trade Investment shpk

Ivi Guri

IVI GURI  


Helios Lamaj



Tiranë 10.02.2023